

---

---

**STATUTI I**  
**SHOQERISE «PAGA VILLAGE »SHPK**

Sot me dt. 02.09.2021 u paraqiten personat si me poshte :

3. **Z. Amarildo OSMËNAJ** shtetase shqiptare, atesia Genci, lindur me 27.09.1991, ne Vlore dhe banuese ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin me nr. J10927051I.
4. **Z. Arkond CANAJ**, shtetas shqiptar, atesia Irfan, lindur me 19.06.1989, ne Vlore dhe banuese ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar me pasaporte kineze nr. I90619097T;

**KREU I-re**

**Dispozita te Pergjithshme**

**NENI 1.**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **“PAGA VILLAGE” SHPK**, eshte themeluar sipas kontrates dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruara nga ortaket e saj.

Kjo shoqeri ne perputhje me Legjislacionin shqiptar, Mbeshtetur ne Ligjin Nr.9901 dt.14/04/2008, "Per Shoqerite Tregtare" dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, personi fizik i mesiperm, ka vendosur te krijohet nga "ORTAKET" per te ushtruar veprimtari te perbashket sipas parashikimeve te bera ne Aktin e Themelimit dhe nga ky Statut.

Emertimi i shoqerise eshte **“PAGA VILLAGE” SHPK** Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti eshte krijuar me mjetet ne pronesi private te themeluesi i saj.

Ajo rregullon poziten juridike te themeluesve dhe punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me **“PAGA VILLAGE” SHPK** eshte person juridik shqiptar dhe e fiton kete te drejte qe nga momenti i regjistrimit te shoqerise ne regjistrin e QKB-se Tirane.

Shoqeria ka vulen e saj ne forme rrethore me madhesi te zakonshme shkruar Shoqeria **“PAGA VILLAGE” SHPK**

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe te rentabilitetit.

**NENI 2**

Veprimtaria operative e shoqerise drejtohet nga Administratori i saj i Pergjithshem. shoqeria **“PAGA VILLAGE” SHPK ka si objekt:**

***Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete kryesisht :***

(Ne fushen e ndertimi shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe te gjitha veprave te tjera madhore, ujesjellesave, Ujrave mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujtese, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, te gjitha restaurimet ne pergjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe cdo



ndertim tjetër i cili në perfundim përben send të paluajtsëm sipas nenit 2 të Kodit Civil për shkak të trupezimit në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me token ose ndërtesën ku është vendosur. Në fushën e minierave shoqëria do të kryejë: Studimin, zbutimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të minierave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si: ndertimin dhe shfrytëzimin e minierave publike dhe private për të tëra llojet e mineraleve, shfrytëzimin e burimeve natyrore të ujërave minerale dhe termale; nxjerrja, prodhimi, përpunimi dhe tregtimi brenda vendit të mineraleve të papërpunuara dhe të përpunuara. Në fushën e turizmit shoqëria do të kryejë: Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të infrastrukurës dhe/ose të pjesëve përberëse të saj, për shfrytëzimin njëzëzë me karakter pushues, argetues, edukues dhe/ose kurues, të burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, të Shqipërisë dhe me gjëre, për realizimin e hotelerisë, fshatë turistike, qendra turistike e të tjera dhe krijimin e faciliteteve dhe aksesoreve të nevojshëm, si bar bufe-restorante, qendra estetike, palestra fitnesi, njësi të shitjeve të konfeksioneve dhe prodhimeve ushqimore e industriale e të tjera të kësaj natyre; Krijimin e agjencive turistike e të tjera. Në fushën e transportit, shoqëria do të kryejë: Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të infrastrukurës dhe/ose të pjesëve përberëse të saj, për transportimin publik dhe/ose privat të njëzëzë dhe mallrave si dhe tranzitimin e tyre përgjatë territorit të Shqipërisë nëpërmjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor, teleferik etj. Shoqëria gjithashtu do të kryejë dhe duke mos u kufizuar vetëm në, aktivitetet e mëposhtme: - Ngarkim dhe shkarkim të anijeve; Pritje dhe levrime të ngarkesave nga dhe për në anije; Stivim, depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numerim, pritje, përpunim, dhe levrime të ngarkesave nga dhe nëpërmjet anijeve. - Sipërmarrje dhe realizimi i çfaredolloj aktiviteti të ligjshëm lidhur dhe në shërbim të ngarkimit dhe shkarkimit të anijeve në çdo vendndërkim, në portë. - Sipërmarrje, përgatitje dhe realizimi i procesit të ngarkimit dhe të shkarkimit të kontenerëve, të mjeteve të tjera transportuese, të anijeve, në interes dhe për llogaritë të pronarit të anijes, përgjithësisht të mjetit transportues, në interes dhe për llogaritë të pronarit të ngarkesës dhe/ose të porositësit të automjeteve/ trenit, anijes apo porositësve të tjerë të ligjshëm. - Sipërmarrje dhe realizimi i ndërmjetësimit dhe transportit, ngarkimit dhe shkarkimit të mallrave me tren e automjete në interes dhe për llogaritë të shoqërisë dhe të Porositësve, persona të tretë. - Ngarkim dhe shkarkim i trenave; Pritje dhe levrime të ngarkesave nga dhe për në stacionet e destinuara; Stivim, depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numerim, pritje, përpunim dhe levrime të ngarkesave nga dhe për transport hekurudhor dhe tokësor; Sipërmarrje dhe realizimi i punëve të ndërmjetësimit, agjencisë dhe të transportit në interes të vetë shoqërisë ose të paleve të treta porositëse. Në fushën e mjedisit shoqëria do të kryejë: Studimin, projektimin, konsulencën, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të mbrojtjes dhe ose përmirësimit si dhe rehabilitimit të kushteve të mjedisit rrethues; përpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike si dhe mbetje të çdo lloji tjetër, trajtimi i ujërave industriale, projektimin, mbikqyrjen në fushën e kërkimit dhe shfrytëzimit të lëndës drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftësimin dhe trajtimin e tokave të kripura e kenetave si dhe çdo veprimtari që ka rëndësi për shoqërinë. Në fushën e prodhimit. Në fushën e shërbimeve. Në fushën e botimeve publikimeve dhe reklamave. Në fushën e tregtisë. Në fushën e Telekomunikacionit. Në fushën e Energjisë ,aktivitetin e



---

---

tregetimit me pakice te karburanteve, mbajtjen e depozitave te karburanteve per efekt te aktivitetit te shoqerise per tregetimin dhe perdorimin e karburanteve per shkak te veprimtarise se saj. Qiradhenie, Bar-Restorant, Parkim, kend lojrash, qender argetimi per femije te te gjitha moshave, qender per zhvillim te lojrave sportive dhe jo sportive, zhvillim trajnimesh, kurse argetuese dhe edukative, sherbime pastrimi (perfshire edhe lavazh automjete).

**NENI 3.**

Shoqeria do te kete Seline e saj ne Tirane , rruga "She Ahmet Pazari" 3,Zona Kadastrale 8160.

**NENI 4.**

Shoqeria pergjigjet per detyrimet e saj me fondet e veta.

**KREU II-te**

**Te drejtat dhe detyrat e Ortakut:**

**NENI 5.**

**Ortaku gezon keto te drejta kryesore:**



- Pjesmarrjen ne rezultatet e cdo forme dhe sasive te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne kontraten dhe statutin e saj.
- Marrjen e te gjitha te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarine e shoqerise, si dhe me te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria, bilancet si dhe llogarite ekonomike,etj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Pergjithshme e Asamblese se Ortakut.
- Te heqi dore nga shoqeria.
- Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.
- Te marri pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesve te tije ose vete.
- Te kerkoje t'i jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregtare te shoqerise, si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.
- Te beje propozime dhe t'i paraqesi ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
- Te emeruje dhe te shkarkojne perfaqesuesit e saj,punonjesit,ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

**Ortaket ka keto detyrime kryesore:**

**NENI 6.**

- Te depozitoje kuoten e tije dhe kuotat suplementare ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te marri pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ai.
- T'i japi shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj.
- Te kryeje detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.

---



8



- 
- 
- ortaku ka te drejte te heqe dore nga shoqeria, duke i njoftuar vendimin e tij asamblese se ortakut ne rast shtimi te ortakeve 6 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e zgjedhjes.
  - Heqja dore nuk e liron ortakun nga detyrimet e marra me pare ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e shoqerise ndaj ortakut.
  - Ti japi shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
  - Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektive te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.
  - Pjesemarrja ne shoqeri nuk i pengon ortaket te kene pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie. Ai nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tej kapitalit themelor ku ata kane marre pjese.

### **KREU III-te**

#### **Kushtet Ekonomike**

##### **NENI 7.**

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes. Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

##### **NENI 8.**

Llogarite vjetore inventari, raportet operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Asamblea e Pergjithshme. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

##### **NENI 9.**

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, vihet nje kapital baze qe perben burimin fillestar per krijimin e fondit themelor dhe te mjeteve te xhiros.

##### **NENI 10.**

Kapitalit themeltar i shoqerise eshte 100.000leke qe zoterohet nga ortaket themelues ne masen 100%.

##### **NENI 11.**

**Z. Amarildo Osmenaj, zoterues i 1 kuote e barabarte me 50.000 Lek**

**Z.Arkond Canaj zoterues i 1 kuote e barabarte me 50.000 Lek**



Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave i marrin ortakut themelues.

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregtare etj.perfitohen prej ortakut themelues te kesaj shoqerie.

Ortaku perballon humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar.Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te tij ortakut kane te drejten e rritjes se tij.

---

---





---

---

Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie ne rast ndarje pasurie ndermjet bashkeshorteve dhe nepermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial.

Shoqeria ne emer te vet eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektin e veprimtarise qe ajo kryen.

Shoqeria mund te shese pasuri ose te shfrytezoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

Shoqeria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

#### **NENI 12.**

Shoqeria eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejte te perdorimit dhe disponimit te kesaj pasurie, ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe kryen. Shoqeria gezon te drejtat per mbrojtjen e pasurise se saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

#### **NENI 13.**

E ardhura bruto e shoqerise, pasi zbritet amortizimi i te gjithe pasurise se lujteshme e te palujteshme, sipas afateve te caktuara, kuotat qe kane te bejne me kredite per investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet per lendet e para apo ndihmese e energjine si dhe shpenzimet e pergjithshme te saksioneve te shoqerise dhe ato per qellime te tjera prodhuese e joprodhuese, i takojne ortakeve te shoqerise.

#### **KREU IV-te**

##### **Administrimi**

#### **NENI 14.**

##### **Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme e Ortakut.**



Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme mund te thirret nga administratori, nga eksperti kontabel i autorizuar. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme mbledhet dhe merre vendime ne baze te nenit 86 dhe 87 te ligjit Per Shoqerite Tregtare.

##### **Asambleja e pergjithshme vendos :**

Per ceshtje te tilla si emerim ose shkarkimin e personelit Injniero-teknik sipas strukturave te ngritura nga shoqeria ,ekspertin kontabel te autorizuar dhe likuiduesit, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, per :

---

---





---

---

Miratimin e programit vjetor te veprimtarise se shoqerise.

Per ceshtje te tilla si ndryshimin e statutit, zvogelimin e pjeseve te kapitalit themeltar, zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar , shnderrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne forma te tjera, mbylljen e shoqerise para kohe.

#### **NENI 15**

Asamblea e Ortakut merr vendime per cdo aspekt te veprimtarise se shoqerise

#### **Kompetencat ekzekutive te Asamblese se Ortakut te shoqerise jane:**

1. Percaktimi i te drejtave kryesore te veprimtarise se shoqerise.
2. Ndryshimet ne emertesen e prodhimit qe do te realizohet dhe te punimeve qe do te kryhen, qe jane pjese perberese e objektit te veprimtarise se shoqerise.
3. Propozimet e nevojshme per ndryshimet ne kapitalin baze te shoqerise.
4. Percaktimi i regjimit dhe i kushteve te zbatimit te parimeve te llogarise ekonomike.
5. Percaktimi i rregullave dhe i normave, qe perkufizojne raportet me gjirin e shoqerise, duke perfshire edhe kuadrin e personelit.
6. Percaktimi i struktures se aparatit te shoqerise.
7. Percaktimi i organikes dhe ndarja e vendeve drejtuese ndermjet perfaqesive te ortakeve.
8. Emertimi dhe zevendesimi i Administratorit te pergjithshem te shoqerise.
9. Krijimi i organeve te tjera te domodoshem per realizimin e objektiveve te shoqerise.
10. Percaktimi i madhesis se kuotave per formimin e kapitalit baze te shoqerise.
11. Paraqitja e propozimeve per rregullimin, krijimin dh perfitimin nga fondet e vecanta, ndarjen e fitimeve dhe percaktimi i rregullave per shlyerjen e borxheve.
12. Marrja e vendimit per krijimin e filialeve te degeve e te perfaqesive si dhe per cedimin e veprimtarise se tyre.
13. Percaktimi i rregulloreve per proceduren e punes te administrates.
14. Pergatitja e propozimit per pushimin e veprimtarise se shoqerise.
15. Perzgjedhja e antareve per komisionin e likujdimit te cilet emrohen dhe rievokohen nga Asamblea e Ortakut.
16. Kryerjen e veprimtarive per likujdimin e llogarive, qe i perkasin ortakut doreheqes te shoqerise.
17. Marrjen e vendimit per kerkimin dhe perdorimin e kredive afatgjata.

#### **NENI 16.**

Veprimtaria operative e shoqerise drejtohet nga Administratori i saj.

Ne shoqerine "**PAGA VILLAGE**" **SHPK** Administrator te shoqerise do te jete **Z. Amarildo OSMËNAJ i cili** ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithe veprimtarine e saj. Me miratimin e ortakut mund te emerohen administrator dhe perfaqesues te shoqerise "**PAGA VILLAGE**" **SHPK** . administratori emerohet per nje kohezgjatje prej pese vjetesh financiare me te drejte riperteritje me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem dhe mund te shtyhet deri ne vendimmarrjen nga Asambleja e Pergjithshme per rinovimin e mandatit ose deri ne zgjedhjen e administratorit te ri. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratoret eshte pergjegjes ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise.



---

---

**Kompetencat e administratorit ne shoqeri jane:**

Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.

- Te beje propozimet e nevojshme ne mbledhjen e asambles kur lind nevoja e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Te miratoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.
- Te krijojte organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
- Te propozoje ne mbledhjen e asamblese per krijimin e njesive, strukturave si filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit apo jashte shtetit.
- Te pergatise propozimet per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe t'ia paraqesin ato Asamblese per miratim.
- Te perzgjedhi ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likujdimit dhe te paraqesin propozimet per miratim ne asamble.
- Te siguroje zbatimin e perpikte te vendimeve te asamblese.
- Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.

-Organizon punen per realizimin e planeve te shoqerise dhe raporton per to ne perputhje me programet e planet e pergjithshme, administron pasurine e shoqerise, duke perfshire ketu mjetet financiare, brenda caqeve te vendimeve te marra nga organi administrativ i shoqerise.

-Drejton e kontrollon veprimtarine e filialeve te degeve e te perfaqesive.

-Perfaqson shoqerine perpara te tretteve si gjykate, etj.

-Nenshkruan kontrata ne emer e per llogari te shoqerise dhe siguron venien e tyre ne jete.

-Merr te gjitha vendimet qe kane te bejne me ato veprimtari te shoqerise, qe nuk jane ne kompetence ekzekutive te Asamblese se Ortakut.

-Raporton dhe i pergjigjet Asamblese per zbatimin e veprimtarive te shoqerise si dhe per realizimin e objektivave dhe detyrave qe jane ne kompetence te tij.

-Siguron drejtimin e shoqerise.

-Perfaqeson shoqerine ne lidhje me te tretet brenda caqeve te objektit te veprimtarise se saj, pervec ceshtjeve qe kerkojne unanimitetin e ortakeve ose qe kane te bejne me kompetencat qe ky statut i atribuon Asamblese se Ortakut.

-Organizon zbatimin e sakte te vendimeve te Asamblese se Ortakut.

-Ben hapjen e leter kredive ne leke e ne valute te huaj.

**NENI 17.**

Per te kontrolluar veprimtarine financiare te shoqerise e te filialeve te saj krijohet komisioni i revizionimit kontabel.

Kryetari dhe antaret e ketij komisioni emerohen nga Asambleja e Ortakut. Kryetari i komisionit emerohet per cdo mandat nga Asambleja.

Komisioni i Revizionimit kontabel perbehet nga 3-5 vete dhe qendron ne detyre per nje periudhe prej tre vjetesh.

Kryetari dhe antaret e komisionit nuk mund te jene ne varesi te shoqerise ose filialeve te saj.

Komisioni i Revizionimit kontabel eshte pergjegjes per veprimtarine e vet perpara Asamblese se Ortakut dhe eshte i detyruar ti paraqese asaj cdo vit raport per kontrollat e bera si dhe konkluzionet per bilancet vjetore.

**NENI 18.**



---

---

**Mardheniet e punes ne shoqeri.**

Marrdheniet e punes ne shoqeri e filiale, ne dege e perfaqesite rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionit shqiptar dhe me kete statut si dhe nepermjet kontrates se punes Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjislacionit te punes. Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje:

Kushtet dhe menyra e marrdhenies se punes.

Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tij ne vendin e punes.

Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes, puna e nates, puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor, festave zyrtare.

Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.

Pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe pergjegjesite e Punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.

Pushimi i marrdhenies se punes.

Paga e punes se punonjesit, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Per te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e rrethit Gjyqesor Tirane.

**KREU V-te**

**Mbyllja e Shoqerise:**

**NENI 19.**

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin te ortakut, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel ose kur ortakut heq dore nga shoqeria si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise (kontrata). Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

**Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet e pakufizuar duke filluar nga 2021 si vit i pare i veprimtarise.**

**NENI 20.**

**Kur shoqeria likujdohet:**

Asambleja e ortakëve meron likujdatorin, te cilit i paraqitet bilanci dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij raporti te hartuar.

Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Te ardhurat cedohen ndermjet ortakëve ne perpjetim me kuoten e vene. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare ndahen ndermjet ortakëve ne perpjestim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.



**NENI 21.**

Kur pushon veprimtaria e nje filiali ,per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakut. Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.

**NENI 22.**

---

---





---

Ky statut hyn ne fuqi menjehere.

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE**

**AMARILDO OSMËNAJ**

*Amarildo Osmënaj*  
*Arh.*

**ARKOND CANAJ**

